



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo




Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0035074-13/26 dt. 29.06.2026

Mitrovicë



Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 17 pika g, pika j, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008); nenin 50, të Ligjit Nr. 05/L-031 Për procedurën e përgjithshme Administrative; nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 29.06.2026, pasi shqyrtoi Njoftimin për korrigjim të Listës së vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, e cila është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0014451-7/26 dt. 27.03.2026; sjell këtë:

VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0014451-7/26 dt. 27.03.2026

1. Me këtë Vendim MIRATOHET plotësim-ndryshimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0014451-7/26 dt. 27.03.2026.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, ndryshohet Raporti mbi vlerësimin e dëmeve në Ekonomi Familjare dhe dëmeve në bujqësi si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, janar 2026, respektivisht Lista e vlerësimit, kështu që në pikën 15 të listës së vlerësimit, shuma e cekur në raport prej 694.00 €, bëhet 6940.00 €.
3. Me këtë ndryshim të njoftohet edhe pala.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë.
5. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI



Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL-së
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
- DSE-së